



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.E.nr.17/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit TEB Sh.A. me seli në P., kundër të paditurve: i padituri i parë, D.P.T. “B.” me seli në Ç., me përfaqësues ligjor – pronarin D. H., e paditura e dytë A. H. nga P., dhe i padituri i tretë NTP “B. K”, me seli në Ç., të cilën e përfaqëson B. Z., ndërsa, të paditurën e parë dhe të tretë, me autorizim tani i përfaqëson avokati Hajzer Salihu nga P., për shkak të kthimit të borxhit të kredisë dhe përkitazi me propozimin e të paditurit të parë dhe të tretë për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike Ek.nr.464/2014 dt.30.10.2017, duke vendosur sipas revizionit të paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë K.Dh.Sh.II.nr.1607/2022 datë 7.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.05. 2024, mori këtë,

A K T V E N D I M

HEDHET si i palejuar revizioni i paditësit TEB Sh.A.me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.Dh.Sh.II.nr.1607/2022 dt.7.12.2023.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë (gjyqtari Individual) K.Dh.Sh.II.nr.1607/22 dt.12.04.2023, është refuzuar si i pabazuar propozimi i të paditurit të parë D.P.T. “B.” me seli në Ç.dhe të paditurit të tretë NTP “B. K”, me seli në Ç., me të cilin kanë kërkuar që të lejohet përsëritja e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike Ek.nr.464/2014 dt.30.10.2017.

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë (në trupin gjykues prej tre gjyqtarësh) K.Dh.Sh.II nr.1607/2022 dt.7.12.2023, është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës së parë dhe të tretë D.P.T.”B.” dhe NPT “B. K” me seli në Ç., ashtu që ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë K.Dh.Sh.II.nr.1607/2022 dt.12.04.2023, aprovohet propozimi i të paditurve për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike Ek.nr.464/2014 i dt.30.10.2017 dhe lejohet përsëritja e procedurës në këtë çështje juridike, ashtu që, anulohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike Ek.nr.464/2014 dt.30.10.2017 dhe shkresat e lëndës i dërgohen Gjykatës së shkallës së parë në kompetencë dhe vendosje.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë K.Dh.Sh.II.nr.1607/2022 dt.7.12.2023, paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni si i bazuar, të priset aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë i datës 7.12.2023, ndryshohet aktvendimi K.Dh.Sh. II.nr.1607//2022 i dt. 7.12.2023, ashtu që refuzohet si i pabazuar propozimi i të paditurit të parë dhe të tretë për përsëritjen e procedurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur, shkresave të lëndës, si dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, sipas nenit 230 lidhur me nenin 218 par.2, pika d) të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pa lejuar.

Duke u nisur nga gjendja e kësaj çështje juridike civile, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se në rastin konkret revizioni i paditësit TEB Sh.A. me seli në P., paraqitur kundër aktvendimit të sipër përmendur, është i palejuar. Kështu, sepse me nenin 240.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet se ” Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovohet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi”, ndërsa, në vijim, me nenin 240.3 të njëjtit ligj, përcaktohet se “ Ankesa kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin refuzohet propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet të njëjtës gjykatë, e cila sipas ankesës vendos në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar ”, kurse, në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar edhe nenin 235 të LPK-së, sipas të cilit “ Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendos gjykata e shkallës së dytë, dhe gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme”. Nga këtu rezulton, gjyqtari individual i gjykatës së shkallës së dytë, e ka refuzuar propozimin e sipër cekur për përsëritjen e procedurës kontestimore, ndërsa, sipas ankesës ka vendosur trupi gjykues i gjykatës së shkallës së dytë, në përbërje prej tre gjyqtarësh, i cili ka marrë aktvendimin e sipër përmendur, me të cilin veç tjerash, e ka aprovuar propozimin e palës së paditur, dhe siç u theksua më lartë, e ka lejuar përsëritjen e procedurës kontestimore.

Në këtë gjendje të çështjes, me qenë se trupi gjykues prej tre gjyqtarësh i gjykatës së shkallës së dytë (neni 240.4 i LPK-së), duke vendosur sipas ankesës, e ka lejuar përsëritjen e procedurës, ndaj, në mënyrë analogjike dhe në përputhshmëri me nenin 240. 3 të LPK-së, të sipër cituar, rezulton se në rastin konkret civil, revizioni është i palejuar.

Nga këtu dhe për arsyet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni është i palejueshëm, ndaj, në mbështetje të dispozitave të nenit 221 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.E.nr.17/2024 datë 15.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha